



Pranuar më: 12.08 2020		
Prilajeno:		
Mesia Jedimica	Numri Broj	Shiojca Dodatak
1-463-	35873	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

KONTRATË

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE GADIME E ULËT

Në mbështetje të neneve 6 par 1 pika 1.2, 14 dhe 15 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/ 03.Prill 2019, Vendimit Paraprak të Kuvendit Komunal Lipjan 15Nr.463-48346 të datës 19.07.2019 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, Vendimit 15Nr.463-26361 të datës 29.06.2020 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Lipjanit, dhe dispozitave të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 10 maj 2012, me datë 12.08.2020 lidhet kjo kontratë ndërmjet palëve kontraktuese:

1. Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson z.Imri Ahmeti,Kryetar i Komunës në vazhdim të tekstit-dhënies i pronës në shfrytëzim
2. "GËRLICA-COMPANY"SH.P.K, me Certifikatën e biznesit 810305616 datë 08.04.2019 (ARBK-ja), adresa: Rruga "Babush" p.n" Ferizaj, përfaqësuar nga pronari Mifail Vogliqi me nr. Personal 2004580977, në vazhdim të tekstit-marrësi i pronës në shfrytëzim.

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1 Objekti i Kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim pa kompensim të pronës komunale për "GËRLICA-COMPANY"SH.P.K, me Certifikatën e biznesit 810305616 të datës 08.04.2019 (ARBK-ja), adresa: Rruga "Babush" p.n" Ferizaj, përfaqësuar nga pronari Mifail Vogliqi me nr. Personal 2004580977, në vazhdim të tekstit-marrësi i pronës në shfrytëzim.

Nr	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqja m ²
1	Pasuri shtetërore K. K. Lipjan	P-71409028-01049-6	Gadime e Ulët	Bujqësore- kullosë kl.6-të	40000



Neni 2

Kohëzgjatja e Kontratës dhe mënyra e shfrytëzimit

1. Parcela kadastrale siç përcaktohen në nenin 1 të kësaj kontrate jepet në shfrytëzim afatgjatë prej 16 vitesh duke filluar nga data 12.08.2020 deri me datë 12.08.2036.
2. Marrësi i pronës në shfrytëzim siç përcaktohen në nenin 1 të kësaj kontrate mund të shfrytëzoj vetëm për llojin e veprimtarisë për të cilën është përzgjedhur, përkatësisht: Shfrytëzimin e shkëmbinjve-seperim të gurëve, apo të ngjashme sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.
3. Marrësi i pronës në shfrytëzim është i obliguar që pas skadimit të kontratës së dhënies së pronës në shfrytëzim afatgjat prej 16 vitesh që të bëjë pyllëzimin e sipërfaqes totale të parcelës kadastrale siç përcaktohet në tabelën e nenit 1 të kësaj kontrate.

II. MARRËVESHJA E PALËVE KONTRAKTUESE

Neni 3

Obligimet e dhënësit të pronës-Komunës

Dhënësi i pronës në shfrytëzim-Komuna obligohet që në afat kohor prej 5 ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës t'ia dorëzojë pronën në posedim Marrësit të tokës në shfrytëzim.

Neni 4

Obligimet e marrësit të tokës në shfrytëzim

1. Marrësi i pronës në shfrytëzim obligohet:
 - 1.1 Që në afat prej 15 ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës të parashtojë kërkesë pranë Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër-Sektorit për Kadastër, për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe t'i kryen njëkohësisht obligimet ligjore që kërkojnë me rastin e regjistrimit të së drejtës së shfrytëzimit.
 - 1.2 Të realizoj planin dinamik të investimeve teknike, rregullimin e pozitës, vendit të fushës së shfrytëzimit të minimumit dhe seperacionit ashtu siç janë prezantuar në ofertë.
 - 1.3 Të ndërtojë infrastrukturën e nevojshme (rrugë deri të punishtja, kanalizim, energji elektrike, etj.) për funksionimin normal të kompanisë.
 - 1.4 Që në afat prej 5 (pesë) viteve nga dita e fillimit të veprimtarisë t'i punësojë 80 persona-punëtorë sezonal, nga procesit të rritjes së linjes së prodhimit të gurëthyesve ashtu siç është përcaktuar në pjesën tekstuale të "Projektit-Tiknoko-Investiv" dhe t'i ofrojë dëshmitë kontratat e punës për të punësuarit ku pjesa dërmuese e tyre duhet të jenë banorë të territorit të Komunës së Lipjanit.
 - 1.5 Të njoftojë zyrën e Kryetarit të Komunës-Sektorin Pronësoro-Juridik për veprimet e ndërmarra dhe dokumentacionin e përgatitur që është objekt i zbatimit të kësaj kontrate.



Neni 12
Hyrja në fuqi

1. Kjo kontratë është përpiluar në 5 ekzemplarë identik prej të cilëve nga një e marrin palët kontraktuese ndërsa nga një ekzemplar do t'i dërgohet Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtoratit të Inspektoratit.
2. Kjo kontratë pas leximit nga palë kontraktuese është nënshkruar dhe vulosur pa vrejtje.
3. Kontrata hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga kontraktuesit dhe do të protokollohet në librat e palëve kontraktuese.

NËNSHKRIMET E PALËVE KONTRAKTUES

Marrësi i pronës në shfrytëzim
"GËRLICA-COMPANY" SH.P.K
Pronari, z. Mifail Vogliqi

Me datë 12.08.2022

Nënshkrimi _____



Dhënësi i pronës në shfrytëzim-Komuna

z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës

Me datë 05/08/2022

Nënshkrimi _____

